



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.15.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
SUHAREKËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Mirlinda Beqiri Udhëheqës ekipi dhe Naim Neziri Anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
5 Qeverisja e mirë.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	26
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	29
Shtojca III: Letër konfirmimi	34

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 13/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Suharekës. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, më përjashtim të keq-klasifikimit të shpenzimeve për pagat përcjellëse të mësimdhënësve me rastin e pensionimit në vlerë 154,679€, të cilat, përmes vendimeve gjyqësore janë ekzekutuar dhe raportuar nga investimet kapitale dhe mallrat dhe shërbimet.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 482,818€, ishin buxhetuar dhe realizuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
- Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000€) të shpalosura në pasqyra si dhe detyrimet kontingjente nuk ishin të sakta dhe të plota.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Suharekës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Gjatë vitit 2017, nga Ministria e Financave janë ekzekutuar pagesa bazuar në vendimet gjyqësore në vlerë prej 246,923€. Prej tyre 154,679€ ishin pagesa për pagat përcjellëse për mësimdhënësit që dalin në pension. Si pasojë e mos planifikimit të buxhetit për pagat ato janë ekzekutuar nga kategoritë tjera (nga investimet kapitale në vlerë prej 131,038€, si dhe nga mallrat dhe shërbimet në vlerë 23,641€). Kjo ka shkaktuar mbivlerësim/nënvlerësim të kategorive ekonomike.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Planifikimi dhe menaxhimi jo i duhur i shpenzimeve ka shkaktuar mbivlerësim të shpenzimeve në kategorinë e investimeve kapitale në vlerë 482,818€. Kjo ka të bëjë me pagesat e realizuara gjatë vitit 2017, për nëntë¹ projekte të cilat për nga natyra i përkasin mallrave dhe shërbimeve;
- Vlera totale e pasurive jo kapitale nën vlerën 1,000€ ishte 230,000€. Komuna nuk e shfrytëzon programin E- pasuria, për evidentimin e tyre, mirëpo ato mbahen në një regjistër në excel. Ky regjistër nuk ofron siguri të plotë për shkak të mundësisë për manipulimin e të dhënave si dhe për shkak se zhvlerësimi i pasurisë bëhet në mënyrë manuale. Për më tepër, blerjet nga investimet kapitale në vlerë totale 32,140€, nuk ishin evidentuar në regjistrin kontabël dhe shpalosur në PFV; dhe
- Komuna në PFV kishte shpalosur 20 raste si detyrime kontingjente në vlerë 157 mijë €. Përmes avokatit komunal ne kemi konfirmuar që shumat e detyrimeve kontingjente të shpalosura në PFV nuk janë të plota, sepse nuk janë shpalosur si detyrime edhe 17 raste tjera në vlerë 121 mijë €. Gabimet në saldon fillestare të detyrimeve kontingjente, komuna nuk ishte në gjendje t'i arsyetoj.

Opinionin jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Komuna ka prezantuar gjendjen e llogarive të arkëtueshme prej mbi 4 milionë €. Prej tyre 484 mijë€ i takojnë kategorisë së dhënies në shfrytëzim të pronës komunale (tokë dhe ndërtesë), për të cilat komuna nuk ka aplikuar kontrole të mjaftueshme apo aktivitete shtesë për arkëtimin e tyre. Në shumicën e rasteve kontratat e qiradhënies me operatorët kishin skaduar, për të cilat faturimi nuk ka ndryshuar pavarësisht lëvizjeve në çmimet e tregut.

¹ 87963 - Mirëmbajtja e objekteve institucionale; 85728 - Vitalizimi i infrastrukturës për funksionalizimin e projektit - shtretërit shtëpiak; 85704 - Mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit; 44501 - Dekorimi i qytetit për festat e fund-vitit; 40962 - Ngritja e kapaciteteve të këshillin e veprimt rinor; 85731 - Rregullimi i ambienteve për aktivitetet kulturore dhe festive të komunës; 40958 - Funksionalizimi i qendrës "Handikos" për Shëndetësi dhe mekanizmave tjerë për shëndetësi; 85712 - Fondi emergjent për mbrojtjen e kulturave bujqësore; dhe 85695 - Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale.

Gjithashtu gjatë vitit 2017 por edhe në vitet paraprake, Komuna e Suharekës është paditur për shuma të konsiderueshme obligimesh nga ana e operatorëve ekonomik dhe të zyrtareve/të punësuarve. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të paditësit, komuna pritet të ketë pasoja të rënda financiare. Komuna duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë trajtimit të detyrimeve kontingjente sidomos për njohjen dhe matjen e tyre.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Suharekës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet mujore dhe tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë, raportet operative (të performancës);
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve.

Në PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2018 ishin të prezantuara gabimet, si:

- Neni 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit, komuna kishte prezantuar edhe të hyrat indirekte nga gjobat dhe dënimet e trafikut, duke mbivlerësuar të hyrat e realizuar; dhe
- Neni 13, Raporti për LLA-të, llogaria e tatimit në pronë ishte mbivlerësuar për 46,000€.

Megjithatë, komuna PFV-të e dorëzuara në mars 2018 i ka korrigjuar gabimet e lartcekura.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, pas korrigjimit dhe dorëzimit të versionit të fundit PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç mangësive të prezantuara të kualifikimi i opinionit dhe theksimi i çështjes të cilat kanë ndikuar në opinionin e auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepet rekomandimi, si:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikimit të opinionit dhe Theksim të Çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të pasurive kapitale dhe shpalosjeve tjera.

Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Suharekës kishte shpenzuar 93% të buxhetit final për vitin 2017, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm, megjithëse ende mbetet sfida realizimi i buxhetit për investime kapitale. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të rritur kontrollet në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë. Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm, përfshirë proceset e prokurimit. Kontrollet mbi pagat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithëse menaxhimi i personelit ka hapësirë të përmirësohet (proceset e rekrutimit).

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	13,783,632	14,599,396	13,606,775	12,773,770	13,587,676
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,848,876	11,788,468	11,707,336	11,384,240	11,617,541
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	841,814	682,570	221,439	564,518
Të hyrat vetjake ⁴	1,934,756	1,934,756	1,183,517	1,164,855	1,389,739
Donacionet e brendshme	-	45	-	-	465
Donacionet e jashtme	-	-	-	3,236	15,413
Financim nga Huamarrja	-	34,313	33,352	-	-

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 815,764€. Ky ndryshim është si rezultat i transferit të financimit nga huamarrja dhe të hyrave të bartura nga viti paraparak dhe zvogëlimit të grantit qeveritar.

Në vitin 2017, Komuna e Suharekës ka shpenzuar 93% të buxhetit final ose 13,606,775€, ngjashëm sikurse në vitin 2016. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	13,783,632	14,599,396	13,606,775	12,773,770	13,587,676
Pagat dhe Mëditjet	8,027,679	8,014,730	7,921,189	7,940,567	7,759,732
Mallrat dhe Shërbimet	1,075,337	1,123,649	1,028,221	965,003	913,344
Shërbimet komunale	262,000	271,550	211,604	249,143	209,235
Subvencionet dhe Transferet	280,999	281,081	278,401	298,137	286,746
Investimet Kapitale	4,137,617	4,908,385	4,167,361	3,320,920	4,418,619

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit të investimet kapitale për 741,024€, vetëm 85% e buxhetit ishte shpenzuar. Programi për Investime Publike përfshinë disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe projekte të reja për vitin aktual;
- Zvogëlimi i buxhetit për paga dhe mëditje për 12,949€ kishte ndodhur në fund të vitit si rezultat i mos shpenzimit të mjeteve nga kjo kategori;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime për 48,312€ është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i mëparshëm dhe financimi nga huamarrja; dhe
- Buxheti për komunalitet ishte rritur për 9,550€. Rritja e buxhetit ishte si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar.

Çështja 2 – Realizimi i ultë i buxhetit për investime kapitale

- E gjetura** Realizimi i buxhetit arrin shkallën prej 93%, ndërkohë sfidë mbetet realizimi jo i kënaqshëm i buxhetit për investime kapitale në 85%, duke bërë që disa nga objektiva e përcaktuara të mos arritën, dhe si të tilla ngarkojnë fondet buxhetore të vitit vijues. Nëse zbatim shpenzimet përmes vendimeve gjyqësore nga kjo kategori (shih opinionin e auditimit) del se niveli i realizimit të investimeve kapitale është akoma me i ulët. Kjo ka ndodhur sepse menaxhmenti nuk ka bërë analiza në baza të rregullta mujore mbi ecuritë buxhetore kundrejt projekteve të synuara.
- Rreziku** Ekzekutimi i ulët i buxhetit tek investimeve kapitale do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion. Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët i tij rezultojnë me më pak projekte/përkrahje për qytetet apo rrezikojnë arritjen e plotë të objektivave të synuara nga komuna.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në vitin 2017 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Suharekës në vitin 2017 ishin në vlerë 1,532,604€, realizimi i të hyrave arrin normën 79% e buxhetit final që krahasuar me vitin paraprak ka rënie për 14%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë e bizneseve, të hyrat nga qiraja etj .

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,934,756	1,934,756	1,532,604	1,786,172	1,815,740
Totali	1,934,756	1,934,756	1,532,604	1,786,172	1,815,740

Përpos të hyrave të prezantuara në tabelë, komuna kishte edhe të hyra indirekte në vlerë 186,607€ (99,410€ janë nga gjobat e gjykatave, si dhe 87,197€ nga dënimet e policisë). Të hyrat vetjake të këtij viti prej 1,183,517€ janë shpenzuar për nevojat e komunës, kurse pjesa e mbetur e të hyrave të arkëtuara në vlerë 349,087€ janë transferuar si suficit për tu shpenzuar në vitin 2018.

Çështja 3 - Mangësi në verifikimin e pronave tatimore

- E gjetura** Bazuar në UA 03/2011, neni 13, zyra komunale e tatimit në pronë është e obliguar të bëjë verifikimin e 1/3 të pronave të regjistruara. Bazuar në planin vjetor komuna gjate vitit 2017 ka shpërndarë 14,309 fatura. Komuna nuk ka ofruar dëshmi lidhur me anketat respektivisht verifikimet e realizuara. I njëjti rekomandim është dhënë edhe në vitin e kaluar, mirëpo edhe përkundër zotimit nga ana e komunës ky rekomandim ka mbetur i pa zbatuar.
- Rreziku** Mos ofrimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara për auditim është në kundërshtim me legjislacionin dhe pamundëson ofrimin e një konkluzioni të saktë të gjendjes. Mos verifikimi i pronave ndikon negativisht në vlerësimin dhe faturimin real të tatimit në pronë dhe mund të rezultojë edhe me nënvlerësimin e të hyrave nga kjo kategori.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të konfirmoj se procesi i verifikimit të pronave është duke u aplikuar bazuar në rregullat, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Azhurnimi i të dhënave për pronat e tatueshme nëpërmes verifikimit të 1/3 së pronës, rezulton me të hyra të sakta komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.

Çështja 4 - Parregullsi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të siguroj kontrole të mjaftueshme në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë. Ne identifikuar parregullsitë si:
- Pronat tatimore nuk i ishin vlerësuar sipas zonave tatimore të përcaktuara në rregullore, si: a) shtatë prona në zonën kadastrale "Krushice e Epërme", për përllogaritjen e tatimit është marrë për bazë zona e pestë, ndërsa me rregullore i takon zonës së katërt; b) për tetë prona në zonën kadastrale "Budakove" prona duhej vlerësuar si zonë e katërt, ndërsa tatimi është përllogaritur si zonë e pestë; c) për tetë prona të zona kadastrale "Semitisht" janë vlerësuar sipas zonës së katërt tatimore, ndonëse i takojnë zonës së tretë; d) të një pronë në zonën kadastrale "Leshan" tatimi është vlerësuar sipas zonës së dytë, ndërsa sipas rregullores i takon zonës së tretë; si dhe e) dy prona, një në "Greikoc" dhe një në "Peqan" tatimi ishte përllogaritur duke marrë për bazë një zonë më të largët tatimore e jo siç parashihet në rregullore;
 - Në 20 raste, komuna nuk ka vepruar në përputhje me nenin 9 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Tatimpaguesve të njëjtë i janë njohur dy e më shumë prona si banim kryesor duke përfituar zbritje prej 10,000€; dhe

- Në 33 raste, në bazën e të dhënave për tatimin në pronë, tatimpaguesit janë identifikuar me më shumë se një numër identifikues, për shkak të regjistrimit të dy ose më shumë pronave. Kjo ka vështirësuar konfirmimin e zbritjes prej 10,000€ për banim kryesor, si dhe ka rritur në mënyrë fiktive numrin e tatimpaguesve në sistem.

Rreziku Mangësitë e identifikuara ndikojnë në vlerësimin jo të saktë të të hyrave të komunës dhe realizim me të ultë të projekteve që priten të financohen nga të hyrat komunale.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet të rishikojë funksionimin e kontrollit në këtë fushë, duke siguruar që të hyrat nga tatimi në pronë vlerësohen dhe menaxhohen bazuar në rregulloret përkatëse.

Çështja 5 – Gabime në kalkulim të taksës për bizneset

E gjetura Komuna e Suharekës bazuar në rregulloren për Taksa dhe Tarifa aplikon taksa në aktivitetet e bizneseve të cilat operojnë në territorin e kësaj komune. Të një rast komuna ka aplikuar gabimisht taksën në aktivitet, duke marrë për bazë adresën e pronarit (zonë rurale), e jo adresën ku operon biznesi në qendër të Suharekës “Qendra Zejtare-2”. Si pasoj nënvlerësimi i taksës për një vit, ishte 199€.

Rreziku Mangësitë e identifikuara ndikojnë në nënvlerësimin e të hyrave të komunës, trajtim jo të barabartë të bizneseve si dhe mos realizim të projekteve që priten të financohen nga këto të hyra.

Rekomandimi 5 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrollit në këtë fushë, duke siguruar që të hyrat vlerësohen sipas rregulloreve përkatëse.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave. Gjate vitit 2017 janë shpenzuar 7,921,189€ për paga dhe shtesa, me një realizim prej 99% e asaj që është planifikuar të realizohet.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Burimet njerëzore përbëjnë një nga instrumentet më të rëndësishëm në procesin e administrimit dhe drejtimit të një organizate buxhetore, si të tilla dhe procesi i rekrutimit, administrimit apo drejtimit të tyre, duhet të ngrihet mbi një strategji të hartuar me kujdes.

Çështja 6 - Dobësi në procesin e rekrutimit për stafin shëndetësor

E gjetura Komuna nuk kishte respektuar kërkesat ligjore të përcaktuara për menaxhimin e procedurave të rekrutimit:

- Neni 5, paragrafi 2, i UA nr 14/2011 i ndryshuar dhe plotësuar me UA 05/2014 Për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, kërkon që për fillimin e procedurave duhet të jenë se paku tri aplikacione të cilat i plotësojnë kushtet sipas konkursit. Në konkursin e shpallur për pozitën “Infermier medicinal në RTG te QKMF-se” ishin vetëm dy kandidat; dhe
- Nuk ishte respektuar afati kohor i ankesave prej 15 ditëve, kërkesë kjo e nenit 6.6 të po të njëjtit UA (kontratat ishin nënshkruar pas një jave nga raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues).

Anashkalimi i procedurave të rregullta të rekrutimit ishte si pasoje e neglizhencës së zyrtareve.

Rreziku Mos respektimi i afateve kohore dhe kërkesave që dalin nga rregullat përkatëse lidhur me numrin e mjaftueshëm të kandidatëve rezultojnë me konkurrencë të mangët me rastin e rekrutimit të punonjësve të ri dhe trajtim të parregullt të konkurruesve.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet t'i rishikojë shkaqet për dobësitë në menaxhimin e procedurave të rekrutimit, dhe të sigurojë se janë dizajnuar kontrollet e duhura në mënyrë që rekrutimet të behën përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitë) në vitin 2017 është 1,395,200€. Prej tyre, ishin shpenzuar 1,239,825€ apo 89% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me furnizimet me dru që marrin pjesë me 13% në total shpenzimin pastaj shpenzimet e rrymës me 8%, furnizimet për zyrë 8% dhe zërat tjerë me të vegjël.

Sipas raportit vjetor të kontratave, janë nënshkruar 52 kontrata për furnizime dhe shërbime në vlerë prej 1,075,112€. Janë zhvilluar edhe 29 procedura me vlera minimale në vlerë prej 22,546€.

Çështja 7 - Ndarje jo e duhur e detyrave

- E gjetura** Te procedura e prokurimit “Furnizim me dru dhe pelet - Lot 2”, menaxher i kontratës, është caktuar i njëjti zyrtari i cili ishte edhe anëtar i komisionit të vlerësimit të tenderit. Në këtë rast, komuna nuk kishte aplikuar ndarje të duhur të detyrave më qëllim të shmangies së konfliktit, bazuar në nenin 62.3 pika 7, të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, përkatësisht neni 81 i ligjit të prokurimit. Kjo ka ndodhur për shkak të mos aplikimit të kontrolleve efektive.
- Rreziku** Mos zbatimi i rregullave dhe udhëzuesve të prokurimit publik rrit rrezikun e shkeljes së parimit të ndarjes së duhur të detyrave për shmangen e çfarëdo konfliktit të mundshëm.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të siguroj se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik dhe kontrollet janë funksionale sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Për vitin 2017, buxheti për subvencione dhe transfere ishte 281,081€ dhe deri në fund të vitit 2017 komuna kishte shpenzuar 278,401€ apo 99% e buxhetit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investimet kapitale në vitin 2017 ishte 4,908,385€. Prej tyre, ishin shpenzuar 4,167,361€ apo 85% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale që marrin pjesë me 39% në total të shpenzimit pastaj investimet në vijim me 13%, mirëmbajtje investive 6% dhe zërat tjerë.

Çështja 8 – Mos përmbushje e kërkesave të dosjes së tenderit (kriteri profesional)

- E gjetura** Komuna të procedura e prokurimit “Sanimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale” kishte vendosur kriterin profesional për sigurimin e një inxhinier të ndërtimtarisë bazuar në njoftim për kontratë, ndërsa OE fitues ka sjellë vetëm bachelor i ndërtimtarisë. Anashkalimi për plotësimin e këtij kriteri, ishte shkaku i mos aplikimit të kontrolleve efektive nga ana e komunës.
- Rreziku** Mos respektimi i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit mund të rezultojë me trajtim dhe vlerësim jo të barabartë të ofertuesve.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të siguroj se në fushën e prokurimit janë duke u zbatuar kontrollet të cilat kanë për qëllim përmbushjen dhe vlerësimin profesional të kriterëve të vendosura, me qëllim të arritjes së synimeve për realizimin e mirëfilltë të kontratave.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 9 – Vlefshmëria e sigurisë së ekzekutimit të pamjaftueshme

- E gjetura** Për tri kontrata siguria e ekzekutimit nuk mbulonte edhe periudhën 30 ditore nga përfundimi i saj. Kjo është identifikuar të kontratat: “Furnizim me dru dhe pelet – Lot 2”; “Sanimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale” dhe “Ndërtimi i qendrës turistike në fshatin Mushtisht – Amfiteater”. Sipas nenit 30.6, të - RRUOP⁵, që siguria e ekzekutimit do të mbetet e vlefshme për një periudhë prej 30 ditësh pas kompletimit të kontratës.

⁵ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik

-
- Rreziku** Mangësitë e identifikuara rezultojnë me mos aplikimin e rregullave dhe mungesë të garancionit apo sigurisë për punët e pranuar. Në raste të dëmtimit të punimeve/mallrave në mungesë të garancionit, komuna mund të përballet edhe me shpenzime shtesë.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të vendos kontrole adekuate dhe monitorim të përshtatshëm për tu siguruar se zbatohen të gjitha kërkesat ligjore gjatë prokurimit dhe komuna aplikon garanci për tu siguruar se ekzekutimi punëve, mallrave apo shërbimeve bëhet në përputhje me marrëveshjet.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna, në PFV 2017 ka shpalosur pasuri kapitale (mbi 1,000) në vlerë prej 282,463,238€ (bazuar në Freebalance) ndërsa pasurinë jo kapitale (nën 1,000) në vlerë prej 230,179€ (bazuar në regjistrin e brendshëm – Excel).

Çështja 10 – Menaxhim jo i duhur i pasurisë

- E gjetura** Komuna nuk ka kryer inventarizimin e pasurisë jo financiare për vitin 2017 bazuar në Rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare - Nr. 02/2013. Mungesa e një procesi të inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë komunale, jo financiare (me vlerë mbi dhe nën 1,000€) para përgatitjes së PFV-ve, nuk ofron siguri se pasuritë në posedim të komunës janë duke u menaxhuar si duhet dhe shpalosjet në PFV ofrojnë informata të drejta dhe të vërteta për lexuesin.
- Rreziku** Kontrollat jo efektive dhe mungesa e një procesi të inventarizimit rezultojnë me njohje dhe vlerësime të pasaktë të pasurive në posedim të komunës.
- Rekomandimi 10** Kryetari duhet të prioritetizoj kompletimin e një inventarizimi gjithëpërfshirës me qëllim të forcimit të kontrollit mbi vërtetimin e saktësisë dhe cilësinë apo gjendjen faktike të pasurisë. Gjithashtu ndryshimet e identifikuara të cilat përcaktohen pas inventarizimit duhet të pasqyrohen në regjistrat e pasurisë.

3.10 Të arkëtueshmet

Komuna e Suharekës ne PFV te vitit 2017 ka shpalosur llogari te arkëtueshme në vlerë 4,047,000€, në të cilat pjesëmarrje me të madhe kanë të hyrat nga tatimi në pronë me 60%, taksat e bizneseve në veprimtari 27% si dhe pjesa e mbetur nga të hyrat e dhënies së pasurisë së patundshme komunale me qira.

Çështja 11 - Shfrytëzimi i pronës komunale me kontrata të skaduara

E gjetura Në pesë raste kishin skaduar kontratat për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim/me qira. Komuna nuk ka ofruar dëshmi tjera për të siguruar se me çfarë baze personat/shfrytëzuesit e pronës vazhdojnë ta shfrytëzojnë pronën komunale. Gjithashtu borxhet e pa arkëtuara nga kjo kategori kanë tendencë rritje, vetme për tri raste, shuma totale e borxhit është 8,486€. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk kishte një monitorim formal për vëzhgimin e obligimeve të papaguara dhe afateve për pagesë.

Rreziku Skadimi i kontratave rezulton me parregullsi në mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave dhe komuna mund të humb të drejtën e inkasimit të rregullt të të hyrave apo arkëtimit të të arkëtueshmeve në mungesë të një kontrate valide.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive opsionet e mundshme për të siguruar se dhënia në shfrytëzim e pronës mbulohet me kontrata duke u bazuar në rregulla dhe ligje në fuqi. Gjithashtu, për të gjitha pronat komunale të dhëna në shfrytëzim, komuna duhet të pranoj pagesën/qiranë e dakorduar bazuar në kontrata apo marrëveshje valide.

3.11 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 63,355€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. detyrimet e papaguara janë zvogëluar për 38% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Komunës së Suharekës ka rezultuar në 11 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, vetëm një rekomandim është zbatuar, dy ishin në proces dhe tetë nuk janë adresuar ende.

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015, ka rezultuar me 14 rekomandime. Nga këto në vitin 2017 janë bartur 10 rekomandime për tu zbatuar prej të cilave katër rekomandime janë në proces të zbatimit dhe gjashtë rekomandime nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 12 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, vetëm një pjesë e vogël e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Kjo tregon një mungesë të përqendrimit të personave përgjegjës në aplikimin e masave konkrete lidhur me adresimin e këtyre rekomandimeve, që vijnë si rezultat i dobësive të identifikuara në komunë.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontroleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës së Suharekës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe mungesa e një roli aktiv të komitetit të auditimit nuk janë të vendosura.

Të gjitha komunat janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj. Komuna e Suharekës posedon vetëm planet urbanistike dhe hapësinore dhe planin e reagimit emergjent, ndërsa obligimet tjera, komuna pretendon t'i plotësojë në të ardhmen.

Ne përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Nga gjithsej 94 rekomandimet e dhëna, në shtatë raporte të auditimit nga NjAB, 63 janë zbatuar, 23 janë në proces të zbatimit dhe tetë kanë mbetur të pa zbatuara. Menaxhmenti ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve, dhe ka përfituar mjaftueshëm nga shërbimet e auditimit të brendshëm. Megjithatë, duhet të angazhohen edhe më tutje për të zbatuar edhe rekomandimet e mbetura.

Çështja 13 – Funksionim jo i plotë i komitetit të auditimit

- E gjetura** Sipas nenit 7, të UA Nr 11/2010 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Sektorin Publik, Komiteti i Auditimit (KA) duhet të përgatit raport vjetor për menaxhmentin e lartë, ku ndër të tjera diskutohen kontrolli i brendshëm, pavarësia e auditorit të brendshëm, dhe efikasiteti i NjAB. KA nuk kishte dorëzuar raport vjetor për menaxhmentit. Për më tepër nga procesverbalet e takimeve të KA-së, ne nuk kemi marrë siguri që të gjitha raportet⁶ e NjAB-së janë diskutuar.
- Rreziku** Mungesa e raporteve për menaxhmentin ulë besueshmërinë mbi efikasitetin e funksionimit të NjAB dhe vetë komitetit.
- Rekomandimi 13** Kryetari duhet të sigurojë që KA mbanë takime të rregullta dhe në procesverbalet e takimeve nxjerrë konkluzione të qarta për menaxhmentin lidhur me çështjet e auditimit të brendshëm.

⁶ “Menaxhimi i proceseve të tatimit në pronë dhe taksave në aktivitet” “Menaxhimi i shpenzimeve në Administratën Komunale” “Rishikimi i procedurave lidhur me identifikimin, evidentimin, klasifikimin, barazimin dhe mirëmbajtjen e pronës së komunës në libra të pasurisë” dhe “Menaxhimi i proceseve të prokurimit me vlera të mesme dhe të mëdha dhe te vogla”

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Çështja 14 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Si pasojë e kontrolleve të dobëta menaxheriale, shumica të konsiderueshme të buxhetit për investime kapitale nuk janë shpenzuar. Problemet me menaxhimin e të hyrave por edhe keq klasifikimet nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Si rezultat i kësaj, disa prej projekteve as që kanë filluar, ndërkohë që disa kontrata janë subjekt i shqyrtimeve gjyqësore.

Organizata gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe as që përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rritë rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Zbatimi i Rekomandimeve e nga viti Paraprak	Kryetari duhet të monitoroj në mënyrë sistematike zbatimin e planit të veprimit dhe të identifikoj arsyet pse i njëjti nuk është zbatuar. Plani i hartuar pas pranimit të këtij raporti, duhet të përcaktoj saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve, dhe stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Komuna ka hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo niveli i zbatimit të tyre ishte i ulët.	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Një rol ndihmës në ngritjen e cilësisë dhe konfirmimit të pohimeve në pyetësorin e vetëvlerësimit, mund të ofroj auditimi i brendshëm përmes rishikimit përfundimtar.		Është bërë rishikimi i pyetësorit të vet-vlerësimit, mirëpo nuk është hartuar strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit si dhe lista e rreziqeve.	
2.5.1 Menaxhimi i Rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se pas hartimit të një liste të rreziqeve me nivelet përkatëse, përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut është deleguar tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi mbarëvajtjen e procesit.			Nuk janë marrë masa.

2.6 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të rishikojë nevojën që planet e auditimit të brendshëm të përshtaten me kërkesat që auditimi i brendshëm të ndjekë aktivitetet gjatë vitit aktual dhe që planet e veprimit të hartohen nga të gjitha njësitë e audituara në mënyrë që rekomandimet e dhëna të implementohen. Gjithashtu, kërkohet një rol më aktiv i Komitetit të Auditimit.		NJAB ka kryer auditime për vitin aktual dhe ka hartuar planin e veprimit, ndërsa komiteti i auditimit nuk ka qenë aktiv në adresimin e çështjeve tek menaxhmenti.	
3.5 Shpenzimet Jo përmes Prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë që marrëveshjet mes komunës dhe OJQ-ve të rishqyrtohen. Duhet të sigurohet se subvencionimi bëhet në harmoni të plotë me rregulloren për subvencione të komunës dhe çdo shmangie nga kjo rregullore do të analizohet dhe gabimet të korrigjohen. Rregulloret e komunës duhet të jenë të qarta dhe të përcaktojnë kriteret dhe shumën e lejuar për të bursave.	Po		
3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të vendosë kriteret të qarta lidhur me trajtimin e kërkesave për subvencione. Të sigurohet që me rastin e subvencioneve të lejuara të kërkohen që të përpilohen raporte përshkruese bashkangjitur me dëshmi dhe fatura për arsyeshmërinë e shpenzimeve dhe të përcillen aktivitetet për të cilat është lejuar subvencion.	Po		
3.6 Të hyrat	Kryetari të vendosë kontrolle të brendshme shtesë në fushën e mbledhjes, barazimit dhe raportimit të të hyrave vetjake. Gjithashtu, zyra e tatimit në pronë të shfrytëzoj të gjitha burimet për verifikim të pronave sipas rregulloreve dhe udhëzimeve administrative. Falja e borxheve të bëhet bazuar në ligjet në fuqi dhe vendimeve të bazuara në rregullore.		Komuna ka arritur të zbatoj pjesën e rekomandimit për faljen e borxheve, mirëpo ende nuk ka arritur të verifikoj 1/3-tën e verifikimit të pronave.	


3.7.2 Trajtimi i Llogarive të arkëtueshme	Kryetari duhet të merr masa të menjëhershme që me zyrtarët përgjegjës financiar të shqyrtoj arsyet e mos prezantimit në PVF të këtyre llogarive. Procesi i monitorimit sistematik të bilanceve, masave dhe politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit. Ne, në auditimin e radhës do të kemi në vëmendje të veçantë masat që ka marrë menaxhmenti në trajtimin e këtij problemi dhe do të nxjerrim konkluzionet e duhura.		Pjesërisht pasi komuna përballet me vlerën e lartë të llogarive të arkëtueshme. Ketë vit po ashtu ka treguar mangësi në inkasimin e të hyrave për qiratë.	
3.7.3 Trajtimi i Llogarive të pagueshme	Kryetari të kujdeset që të gjitha faturat paguhen me kohë sipas kontratave dhe obligimet e mbetura pa paguar prezantohen saktë në raportet financiare të komunës. Kryetari duhet të rishikoj sistemin e menaxhimit të detyrimeve të papaguara, për t'iu shmangur ekzekutimin direkt të pagesave nga MF dhe gjykatat.	Po		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1. Pasqyrat financiare	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në klasifikimin e shpenzimeve dhe pasuritë.		Përkundër përmirësimeve, edhe me tutje komuna përballet me dobësi të cilat janë prezantuar të opinionit i auditimit.	
2. Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të vendos dha zbatoj mekanizma konkret të llogaridhënies ndaj të gjithë personave përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve. Pas pranimit të këtij raporti, ne sugjerojmë që të përgatitet një plan i rifreskuar i veprimit për të zbatuar rekomandimet e këtij viti dhe rekomandimet e vitit të kaluar, duke përcaktuar qartë afatet kohore, veprimet dhe personat përgjegjës për realizimin e këtij plani. Një proces monitorimi, po ashtu duhet zbatohet.			Nuk janë marrë masa.

3. Pyetësi i vetvlerësimit të komponentave të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se do të hartohet lista e rreziqeve dhe plani i zhvillimit strategjik. Monitorimi i strategjisë duhet të bëhet në baza të vazhdueshme për tu siguruar se objektivat strategjike janë duke u arritur. Njësia e auditimit të brendshëm duhet të përfshihet në procesin e rishikimit për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese.			Nuk janë marrë masa.
4. Dokumentet Strategjike	Kryetari duhet të siguroj se do të hartoj një plan të përgjithshëm strategjik për komunën duke përfshirë koston e strategjisë, të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore. Të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave, duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.			Nuk janë marrë masa.
5. Zbatimi i Rekomandimeve të NjAB	Kryetari duhet të siguroj hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit sipas sektorëve dhe të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm, dhe në baza mujore t'i monitoroj ato. Komiteti i auditimit në procesverbalet e takimeve, të nxjerrë konkluzione të qarta për menaxhmentin lidhur me çështjet e auditimit të brendshëm.		Ka filluar aplikimi i planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por komiteti nuk ka arritur t'i shqyrtoj të gjitha raportet e NjAB-së.	
6. Shpenzim i ulët i të hyrave vetjake.	Kryetari duhet të sigurohet që me rastin e planifikimeve buxhetore, të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i burimeve potenciale dhe të përcaktoj opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale për vitin 2017. Një monitorim sistematik i trendëve buxhetore do të rriste mundësitë për një performancë më efektive.	Po		
7. Tatimi në pronë.	Kryetari duhet të siguroj një rishikim të sistemeve ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat e vendosur për mbledhjen e të hyrave janë adekuat dhe mund të funksionojnë në mënyrë efektive. Verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parashihet me ligj.			Nuk janë marrë masa.


8. Kontrollle të dobëta në qiradhënie komunale	Kryetari duhet të siguroj se do të rishikohen kontratat për qiradhënie dhe do të hartohet një plan masash ku do të përcaktohen afatet kohore shtesë për kryerjen e pagesave dhe përgjegjësit për zbatimin e masave të propozuara në mënyrë që të mblidhen borxhet e mbetura, si dhe në baza të rregullta të inkasohen borxhet aktuale. Në të kundërtën, shfrytëzimi i pronave publike nuk duhet lejuar.			Nuk janë marrë masa.
9. Vlerësimi i mësimdhënësve	Një shqyrtim sistematik i Dosjeve të Personelit në arsim duhet të ndërmerret, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë në dosje. Vlerësimi i punëtorëve duhet të kryhet çdo viti shkollor, dhe po ashtu të gjithë mësimdhënësit që i plotësojnë kushtet ligjore, të pajisen me kontratë në kohë të pacaktuar.			Nuk janë marrë masa.
10. Menaxhimi i pasurisë	Kryetari duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit të E-pasurisë dhe të fuqizoj kërkesat që të gjitha pasuritë nën 1,000€ të regjistrohen në këtë sistem. Nëse sistemi për arsye teknike nuk mund të përdoret, të dhënat mbi pasuritë dhe stoqet duhet të evidentohen dhe përditësohen në ndonjë program tjetër, duke mos e përjashtuar programin Excel.			Nuk janë marrë masa.
11. Menaxhimi i llogarive te arkëtueshme	Kryetari duhet të shqyrtoj ngritjen e një grupi pune të veçantë për shqyrtimin e inkasimit të borxheve. Komuna duhet të bëjë një analizë në mënyrë që të identifikoj shkaktarët e dështimit në pagesën e borxheve, të miratoj një strategji me masa konkrete si dhe të shfrytëzojë të gjitha mjetet në dispozicion, duke përfshirë edhe veprimet ligjore.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
DËRGOUAR - DOSTAVLJENO - SENT			
Nr. Br. No.	Data Datum Date	Seria Serište No.	Adresa Adresa Address
01	25.06.2018		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINA SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA




KRYETARI I KOMUNËS

Nr 01-06-35330

Datë 25.06.2018

PËR: Zyrën Kombëtare të Auditimit

NGA: Bali Muharremaj Kryetar *Bali Muharremaj*



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Të nderuar,

Përmes kësajshkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Suharekës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.